



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:004828

Datë: 19.11.2021

Numri i dokumentit: 02417963

**PA1.nr.1003/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit Xh. Sh., nga fshati Z....., për shkak të kryerjes së veprës penale Mashtrimi, nga neni 323 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e të akuzuarit Xh. Sh., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.66/2021, datë 19.05.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPP-ës , më datë 28.10.2021 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e të akuzuarit Xh. Sh., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.66/21 datë 19.05.2021, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prizren, me aktgjykimin, P.nr.66/2021, datë 19.05.2021, të akuzuarin Xh. Sh. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Mashtrimi, nga neni 323 par. 1 të KPRK-ës dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) €, të cilin dënim i akuzuari është obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk mund apo nuk dëshiron ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, dënimin me gjobë do të ia zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 (njëzet) i llogaritet 1 (një) ditë burgim. Gjithashtu i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Po ashtu i ka shqiptuar dënim plotësues ashtu që urdhërohet i akuzuari Xh. Sh. që ta bëjë dëmshpërblimin e palës së

dëmtuar M. N. në shumë të përgjithshme prej 5.350 €, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë, në emër të dëmit të shkaktuar nga kryerja e veprës penale në përputhje me nenin 59 par.2 nënpar.2 të KPRK-së. Është obligua i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sa do që të bëhen ato, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm. I dëmtuari, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar i akuzuari Xh. Sh. , për shkak të vendimit mbi dënimin me propozim që Gjykata e Apelit ankesën ta aprovojë në tërësi si të bazuar, ashtu që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe të akuzuari ti mundësohet një dënim më i butë ose i kushtëzuar.

Prokurori i Apelit në Prishtinë me parashtrësën PPA/II.nr.1019/2021 datë 03.08.2021 ka propozuar që ankesa e mbrojtëses të akuzuari të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit caktoj seancën e kolegjit konform nenit 390 të KPP-së, për mbajtjen e ë cilës në mënyrë dhe kohë të rregullt u njoftuan Prokurori i Apelit, i akuzuari Xh. Sh., mbrojtësja e të akuzuari av. Pranvera Ukaj si dhe i dëmtuari M. N. Mbrojtësja e të akuzuari – avokate Pranvera Ukaj deklaroi se: mbetet në tërësi pranë ankesës së parashtruar me shkrim dhe propozon që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të mbrojturit të tij të i shqiptohet dënim i kushtëzuar. Palët tjera edhe pse të ftuara në mënyrë të rregullt nuk prezantuan në seancë.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të nenit 394 të KPP, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë gjeti se:

**- Ankesa nuk është e bazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës se nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuari.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

I akuzuari me ankesë përkitazi me vendimin mbi dënimin pretendon se dënimi i shqiptuar ndaj tij është tejet i lartë, me gjendjen time ekonomike ngase jam i vetmi mbajtës i familjes,

kujdesem edhe për vëllain tim i cili është me aftësi të kufizuara dhe nëse unë gjendem në vuajtje të dënimit nuk ka kush të kujdeset për të. Sa i përket dëmit të cekur në aktgjykim unë kam pranuar të paguaj dëmin e shkaktuar po se është bërë një gabim teknik për shkak se dëmi është në shumë prej 4.350 € e jo siç është cekur në aktgjykim shuma prej 5.350 €. Andaj nga gjitha këto propozon që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit të i shqiptohet dënim me kusht.

Pretendimet e lartë cekura të të akuzuarit sa i përket vlerës së dëmit të shkaktuar nuk qëndrojnë dhe të njëjtat janë të pabazuara ngase si nga dispozitivi i akuzës po ashtu edhe nga dispozitivi i aktgjykimit vërehet se vlera e dëmit të shkaktuar të të dëmtuarit nga ana e të akuzuarit është 5.350 € e jo 4.350 € ashtu siç pretendon i akuzuari. Vet i akuzuari e ka bërë pranimin e fajësisë për veprën penale dhe se në aktakuzë është e përcaktuar vlera e dëmit në shumë prej 5.350 € që i akuzuari me veprimet e tija inkriminuese të përshkruara në dispozitivin e akuzës i janë shkaktuar të dëmtuarit, andaj një pretendim të tillë të të akuzuarit Kolegji penal i kësaj gjykate e refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore të të akuzuarit që ndaj të njëjtit të shqiptohet një dënim më i butë, apo ndonjë dënim alternativ, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë konform dispozitës së nenit 69 dhe 70 të KPRK, i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, me ç ‘rast si rrethana veçanërisht lehtësuese për të akuzuarin ka marrë faktin se i akuzuari ka pranuar fajësinë, pendimin dhe keqardhjen për rastin e ndodhur, kërkim faljen dhe gatishmërinë që të dëmtuarit të i kompensoj dëmin e shkaktuar material si dhe premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale. Ndërsa si rrethana rënduese mori shkallën e përgjegjësisë penale, dashjen direkte, mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale – keqpërdorimin e besimit të të akuzuarit ndaj të dëmtuarit, motivet e kryerjes së veprës penale me qëllim të përfitimit material nga veprimi i kundërligjshëm si dhe sjelljen e mëparshme të të akuzuarit pasi që i njëjti në evidencën zyrtare penale të gjykatës figuron se është kryes i mëhershëm i veprave penale të kësaj natyre, andaj në prani të këtyre rrethanave gjykata e shkallës së parë i ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar me bindje se edhe me dënime të tilla do arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e të akuzuarit për një dënim më të butë – dënim të kushtëzuar nuk janë të atij karakteri dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarit t’i shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t’i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me këtë kryerësin do ta parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij, kjo gjykatë

konsideron se dënimi i shqiptuar është e mjaftueshme për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVES**

PA1.nr.1003/21, datë 28.10.2021

**Zyrtarja ligjore,**

Rrezarta Bala

**Kryetar i kolegjit**

Hashim Çollaku

### **Anëtarët e kolegjit:**

Ferit Osmani

Zyhdi Haziri